



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

22, 7 2022

14115

URDHËR

Nr. 187, Datë 22.7.2022

**“PËR
SHPLLJEN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES DHE PROCESIT TË APLIKIMIT,
PËR ADMINISTRATORËT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, (NJVQV-
VE QË MUND TË JENË NË KUSHTET E VËSHIRËSIVE SERIOZE FINANCIARE
APO PAAFTËSISË PAGUESE)”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 5, të nenit 59 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” dhe pikave 157 dhe 171, të Udhëzimit nr.26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

URDHËRON:

1. Shpalljen e kriterëve të përzgjedhjes dhe fillimin e procesit të aplikimit, për administratorët e njësive të vetëqeverisjes vendore, (NJVQV-ve që mund të jenë në kushtet e vështirësive serioze financiare apo paaftësisë paguese).
2. Aplikanti për administrator i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë arsimuar në shkencat ekonomike ose shkencat juridike (me master shkencor);
 - b) Të ketë eksperiencë në punë të paktën 10 vite në administratën publike;
 - c) Të ketë njohuri të thelluara dhe kualifikime në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel vendor;
 - d) Nuk duhet të ketë konflikt interesi me njësitë e qeverisjes vendore.
3. Afati i aplikimit të kandidatëve për t'u përzgjedhur në listën e administratorëve të njësive të vetëqeverisjes vendore është 40 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
4. Aplikanti do të dorëzojë në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesë me shkrim;
 - b) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - c) Adresën e vendbanimit, vendit të punës dhe pikave të kontaktit;
 - d) Kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;

- e) Një fotografi të përmasave 4 x 6;
 - f) Kopje të licensave dhe/ose certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj;
 - g) Dëshmi dhe çertifikata të trajnimeve dhe kualifikimeve pasuniversitare;
 - h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shpërndalet nëpërmjet rrugëve elektronike zyrtare dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare (QBZ).
6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

